



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

AUTORITETI PËR INFORMIMIN MBI DOKUMENTET E ISH-SIGURIMIT TË SHTETIT
SEKRETARI I PËRGJITHSHËM

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më ____ .04.2025

Lënda: Përgjigje kërkesës së paraqitur nga z. M.K.
E-mail:

TIRANË

I nderuar z. K.!

Në përgjigje të kërkesës tuaj për informacion, drejtuar Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit (Autoriteti), me tonën nr. 771 prot., datë 09.04.2025, me anë të së cilës në zbatim të ligjit për të drejtën e informimit (pra ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit” i ndryshuar) kërkon të informoheni *“nëse përfaqësuesi i ardhshëm i qytetarëve të Elbasanit në zgjedhjet parlamentare të 11 Majit në listën e mbyllur të Qarkut Elbasan të subjektit Partia Demokratike, Aleanca për Shqipërinë Madhështore ku kandidon ndër të tjerët edhe A.B. (që do të jetë përfaqësues i Partisë Demokratike) rezulton të ketë qenë bashkëpunëtorë i sistemit të sigurimit të shtetit gjatë sistemit komunist. Në këtë kuadër, përbën interes të lartë publik informacioni i kërkuar”*, Ju informojmë si më poshtë:

Në zbatim të ligjit nr. 45/2015 “Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë” i ndryshuar, Autoriteti, nuk nis procedurë verifikimi të pastërtisë së figurës kryesisht pra me iniciativën e tij, por vetëm pas bërjes së kërkesës, në rastin konkret nga subjektet politike apo kandidatët për deputetë në Kuvendin e Shqipërisë për qëllime të përmbushjes së funksioneve të tij.

Sa më sipër, në Autoritet nuk është paraqitur deri më tani asnjë kërkesë për verifikim të figurës së shtetasit sipas objektit të kërkesës tuaj, as nga subjektet politike dhe as me iniciativë personale, pavarësisht kërkesave të vazhdueshme të Autoritetit drejtuar subjekteve politike të regjistruara në çdo zgjedhje për kryerjen e verifikimeve.

Kordinatori i të drejtës për informim pranë Autoritetit
L. Cocoli

SEKRETARI I PËRGJITHSHËM

Sofi Noti